

BANKA QENDRORE EVROPIANE



W. F. Duisenberg, presidenti i BOE-së

EURO – MONEDHA E RE E EVROPIANËVE

Që nga 1 janari 1999 Evropa ka një monedhë të re, Euron. Në këtë ditë, euro zëvendësoi monedhat kombëtare të 11 vendeve: Belgjikës, Gjermanisë, Spanjës, Irlandës, Italisë, Luksemburgut, Holandës, Austrisë, Portugalisë dhe Finlandës. Më 1 janar 2001 ajo i zuri vendin edhe monedhës kombëtare të Greqisë. Këto 12 vende që përdorin euron përbëjnë atë që quhet Eurozonë. Vetëm tre nga vendet e Komunitetit Evropian: Danimarka, Suedia dhe Anglia, nuk e kanë adoptuar ende këtë monedhë si të tyre.

Adoptimi i një monedhe të vetme nga rreth 300 milionë evropianë ka sjellë përparësi të jashtëzakonshme si për konsumatorët ashtu edhe për bizneset. Përdorimi i saj lehtëson tregtinë e mallrave dhe të shërbimeve ndërmjet vendeve pjesëmarrëse në këtë marrëveshje, duke forcuar krijimin e një tregu të vetëm në Komunitetin Evropian. Për kompanitë që merren me import-eksport, tani rreziku i kursit të këmbimit vlen vetëm në ato vende që nuk bëjnë pjesë në Komunitetin Evropian.

Lehtësi krijohet edhe për udhëtarët. Pas hyrjes së euros në vitin 2002, ata që udhëtojnë brenda Eurozonës, nuk kanë nevojë të këmbëjnë para apo të paguajnë komisione për këto shkëmbime. Për më tepër, përdorimi i të njëjtës monedhë në 12 vende i bën çmimet të krahasueshme për gjithë Zonën. Të tëra këto, çojnë në rritje të konkurrencës dhe të mirëqenies në Eurozonë.

Euro synon të jetë një monedhë po aq e qëndrueshme sa edhe ish-monedhat kombëtare të vendeve të Eurozonës. Tani, është detyrë e Bankës Qendrore Evropiane që të sigurojë stabilitetin e çmimeve në Eurozonë. Për të arritur këtë, Banka Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore të secilit nga vendet e Eurozonës bashkëpunojnë për ushtrimin e një politike të vetme monetare. Sigurisht që edhe qeveritë e vendeve përkatëse luajnë një rol të rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve nëpërmjet implementimit të politikave fiskale.

Vendet që duan të hyjnë në Eurozonë, pra të përdorin monedhën Euro, duhet të përmbushin një sërë

kriteresh ekonomike si: nivel të ulët inflacioni, politika të shëndosha financiare publike, nivele të ulëta të normës së interesit dhe kurs këmbimi të qëndrueshëm. Gjithashtu, ato duhet të garantojnë pavarësinë

politike të bankës qendrore. Përmbushja e këtyre kriterëve të konvertimit – të njohura si kriteret e Maastricht-it – përbën bazën e kushteve për implementimin e monedhës së re.

KURSET FIKSE QË U PËRDORËN PËR KËMBIM:

1 euro =	40.3399	franga belge
	1.95583	marka gjermane
	340.750	dhrahmi greke
	166.386	peseta spanjolle
	6.55957	franga franceze
	0.787564	paund irlandez
	1,936.27	lireta italiane
	40.3399	franga luksemburgase
	2.20371	gilda holandeze
	13.7603	shilinga austriake
	200.482	eskude portugeze
	5.94573	marka finlandeze

BANKA QENDRORE EVROPIANE

Banka Qendrore Evropiane ruan stabilitetin e çmimeve në Eurozonë. Ajo është themeluar më 1 qershor 1998 dhe është një nga bankat qendrore më të reja në botë. Megjithatë, ajo mbart kredibilitetin dhe profesionalizmin e trashëguar nga të gjitha bankat qendrore të Eurozonës.

Krijimi i Bankës Qendrore Evropiane mbështetet në Traktatin për themelimin e Komunitetit Evropian (Traktati). Sipas statistikave të muajit mars 2001, në zyrat qendrore të Bankës Qendrore Evropiane që ndodhen në Frankfurt, Gjermani, punojnë rreth 1000 persona. Ata janë rekrutuar nga 15 vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe në bashkëpunim me stafin e bankave qendrore të çdo vendi anëtar punojnë për implementimin e vendimeve të organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore Evropiane.

Organi më i lartë vendimmarrës i Bankës Qendrore Evropiane është **Këshilli Drejtues**. Ai përbëhet nga gjashtë anëtarë të Bordit Ekzekutiv dhe nga 12 guvernatorët e bankave qendrore të Eurozonës. Si Këshilli Drejtues, ashtu

edhe Bordi Ekzekutiv drejtohen nga Presidenti i Bankës Qendrore Evropiane. Detyra kryesore e Këshillit Drejtues është formulimi i politikës monetare të Eurozonës. Në veçanti, ai ka fuqinë të përcaktojë normat e interesit me të cilat bankat tregtare të secilit prej vendeve të Eurozonës, mund të sigurojnë likuiditet nga banka qendrore e tyre. Kështu, Këshilli Drejtues në mënyrë indirekte ndikon mbi normat e interesit në ekonominë e Eurozonës.

Këshilli Drejtues.



Mbrapa (nga e majta në të djathtë): V. M. Constâncio, J.-C. Trichet, N. C. Garganas, G. Quaden, M. Vanhala, K. Liebscher, E. Welteke, Y. Mersch, J. Hurley, J. Caruana, A. Fazio, N. Wellink.

Përpara (nga e majta në të djathtë): T. Padoa-Schioppa, O. Issing, L. D. Papademos, W. F. Duisenberg, S. Hämmäläinen, E. Domingo Solans.

Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore Evropiane përbëhet nga Presidenti, Zëvendës-presidenti dhe katër anëtarë të tjerë. Ata zgjidhen me marrëveshje nga kryetarët e 12 shteteve, anëtare të Eurozonës. Bordi Ekzekutiv është përgjegjës për implementimin e politikës monetare sipas udhëzimeve të Këshillit Drejtues dhe në funksion të kësaj detyre ai u jep instruksionet e nevojshme bankave qendrore të 12 vendeve. Gjithashtu, ai përgatit takimet e Këshillit Drejtues dhe administron punën e përditshme të Bankës Qendrore Evropiane.

Foto, Bordi Ekzekutiv.



*Mbrapa (nga e majta në të djathtë): E. Domingo Solans , O. Issing, T. Padoa-Schioppa.
Përpara (nga e majta në të djathtë): L. D. Papademos, W. F. Duisenberg, S. Hämläinen.*

Organi i tretë vendimmarrës i Bankës Qendrore Evropiane është **Këshilli i Përgjithshëm**. Ai përbëhet nga Presidenti, Zëvendës-presidenti dhe guvernatorët e 15 bankave qendrore të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Këshilli i Përgjithshëm kontribuon në funksionet këshilluese dhe koordinuese të Bankës Qendrore Evropiane dhe në përgatitjet për zgjerimin e Eurozonës. Njësitë organizative të Bankës Qendrore Evropiane janë të ndara në Direktorate të Përgjithshme dhe Direktorate, të cilat janë të varura nga anëtarët e Bordit Ekzekutiv.

Foto, Këshilli i përgjithshëm.



*Mbrapa (nga e majta në të djathtë): N. C. Garganas, G. Quaden, M. Vanhala, K. Liebscher, E. Welteke, Y. Mersch, E. A. J. George, J. Hurley, J. Caruana, N. Wellink, A. Fazio.
Përpara (nga e majta në të djathtë): V. M. Constâncio, J.-C. Trichet, L. D. Papademos, W. F. Duisenberg, B. Nyboe Andersen, U. Bäckström.*

EUROSISTEMI

1 2 bankat qendrore të Eurozonës së bashku me Bankën Qendrore Evropiane përbëjnë atë që njihet si Eurosistemi. Ky term u zgjodh nga Këshilli Drejtues për të bërë dallimin me termin Sistemi Evropian i Bankave Qendrore (ESCB). Ky i fundit është krijuar mbi bazën e Traktatit për themelimin e Komunitetit Evropian dhe përbëhet nga Banka Qendrore Evropiane dhe 15 bankat qendrore të vendeve anëtare në Bashkimit Evropian. Përsa kohë që ka ende vende anëtare të Bashkimit Evropian, por jo të Eurozonës, si Danimarka, Suedia dhe Britania e Madhe, dallimi midis Eurosistemit dhe Sistemit Evropian të Bankave Qendrore është i nevojshëm.

Drejtimi i Eurosistemit kryhet nëpërmjet organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore Evropiane. Vendimet merren nga Këshilli Drejtues dhe Bordi Ekzekutiv, ndërsa Këshilli i Përgjithshëm kryen vetëm funksionin e këshilltarit në Eurosistem. Kjo sepse, siç u përmend

më sipër, ai përfshin edhe përfaqësuesit e tre bankave qendrore të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, por që nuk ndodhen në Eurozonë. Këto tre shtete kanë monedhat e tyre kombëtare dhe ndjekin politika të pavarura monetare.

Vendimet e politikës monetare që Banka Qendrore Evropiane merr në lidhje me Eurosistemin, transmetohen në ekonomitë e vendeve të Eurozonës nëpërmjet sistemit bankar të secilit prej këtyre vendeve. Rreth 8,000 institucione krediti (banka tregtare, banka kursimi dhe institucione të tjera financiare) në 12 vendet e Eurozonës shërbejnë si kanale për transaksionet e politikës monetare, të cilat synojnë të rregullojnë nivelin e likuiditetit në Eurozonë. Është e natyrshme që zhvillimet e sektorit bankar në Eurozonë të monitorohen nga afër nga Eurosistemi, sikurse parashikohet në Traktatin për themelimin e Komunitetit Evropian. Megjithatë, përgjegjësia direkte për mbikëqyrjen bankare qëndron mbi autoritetet kombëtare.

FUNKSIONET KRYESORE TË EUROSISTEMIT JANË:

- formulimi dhe zbatimi i politikës monetare për Eurozonën;
- kryerja e operacioneve në tregun e këmbimit valutor dhe ruajtja e administrimi i rezervave valutore zyrtare për vendet e Eurozonës;
- emetimi i kartëmonedhave euro; dhe
- mbështetja për funksionimin e duhur të sistemit të pagesave.

FUNKSIONE TË TJERA JANË:

- të mbledhë informacionin e nevojshëm statistikor nga autoritetet kombëtare dhe nga agjentët ekonomikë, si për shembull nga institucionet financiare;
- të mbikëqyrë zhvillimet në sektorin bankar dhe financiar; dhe
- të përkrahë shkëmbimin e informacionit midis Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse të çdo vendi.

SISTEMI EVROPIAN I BANKAVE QENDRORE (ESCB)

Këshilli i përgjithshëm

Banka Qendrore Evropiane (ECB)

Këshilli drejtues

Banka Kombëtare e Belgjikës
(Bank van België)

Banka Kombëtare e Gjermanisë
(Deutsche Bundesbank)

Banka e Greqisë
(Bank of Greece)

Banka e Spanjës
(Banco de Espana)

Banka e Francës
(Banque de France)

Banka Qendrore e Irlandës
(Central Bank of Ireland)

Banka Kombëtare e Danimarkës
(Danmark Nationalbank)

Banka e Suedisë
(Sveriges Riksbank)

Bordi ekzekutiv

Banka e Italisë
(Banca d'Italia)

Banka Qendrore e Luksemburgut
(Banque centrale du Luxembourg)


Banka e Holandës
(De Nederlandsche Bank)

Banka Kombëtare e Austrisë
(Oesterreichische Nationalbank)

Banka e Portugalisë
(Banco de Portugal)

Banka e Finlandës
(Suomen Pankki)

Banka e Anglisë
(Bank of England)



OBJEKTIVI I EUROSISTEMIT - STABILITETI I ÇMIMEVE.

Objektivi i parë i Eurosistemit është ruajtja e stabilitetit të çmimeve në Eurozonë, duke mbrojtur fuqinë blerëse të monedhës euro. Sigurimi i stabilitetit të çmimeve është kontributi më i rëndësishëm që mund të japë politika monetare në arritjen e një mjedisi të favorshëm ekonomik me një nivel të lartë punësimi. Si inflacioni, ashtu edhe

deflacioni mund të jenë të kushtueshëm për popullsinë në aspektin social dhe në atë ekonomik. Pa cënuar objektivin primar të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, Eurosistemi mbështet edhe politika të përgjithshme ekonomike të zbatueshme në Komunitetin Evropian. Si pjesë e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, ai vepron në përputhje me parimet e një ekonomie të hapur sikurse përcaktohet në Traktatin për themelimin e Komunitetit Evropian.

TRAKTATI PËR THEMELIMIN E KOMUNITETIT EVROPIAN, NENI 105.

OBJEKTIVI KRYESOR I SISTEMIT EVROPIAN TË BANKAVE QENDRORE DO TË JETË AI I RUAJTJES SË STABILITETIT TË ÇMIMEVE.

HO/EDMÄLET FOR ESOB ER AT FASTHOLDE PRISSTABILITET.
DAS VORRATTOGE ZIEL DES ESR/ES IS DIE PREISS ABHÄNGIGKEIT ZU GEWÄHRLESEN.

ΠΡΩΤΑΡΧΙΚΟΣ ΣΤΟΧΟΣ ΤΟΥ ΣΕΚΤ ΕΙΝΑΙ Η ΔΙΑΤΗΡΗΣΗ ΤΗΣ ΣΤΑΘΕΡΟΤΗΤΑΣ ΤΩΝ ΤΙΜΩΝ
THE PRIMARY OBJECTIVE OF THE ESCB SHALL BE TO MAINTAIN PRICE STABILITY

EL OBLJETIVO PRINCIPAL DEL SEBC SERA MANTENER LA ESTABILIDAD DE PRECIOS

L'OBJECTIF PRINCIPAL DU SEBC EST DE MANTENIR LA STABILITÉ DES PRIX

L'OBIETTIVO PRINCIPALE DEL SEBC È IL MANTENIMENTO DELLA STABILITÀ DEI PREZZI

HET HOOFDOEL VAN HET ESOB IS HET HANDHAVEN VAN PRIJSSTABILITEIT

O OBJECTIVO PRIMORDIAL DO SEBC É A MANUTENÇÃO DA ESTABILIDADE DOS PREÇOS

EKPIN ENSISLAISENA TAVOITTEENA ON PIÄÄ YLLÄ HIN ATASON VAKAUTTA

HUVUDVALET FÖR ESOB SKALL VARA ATT UPPRÄTHÅLLA PRISSTABILITET

Me qëllim që të jetë më e lehtë për publikun, të vlerësojë suksesin e politikës monetare të Eurozonës, Banka Qendrore Evropiane ka shpallur më konkretisht objektivin kryesor të saj. Stabiliteti i çmimeve është përcaktuar si rritje vjetore prej më pak se 2 për qind e çmimeve të konsumit. Dihet se në periudha afatshkurtra, çmimet nuk kontrollohen nga politika monetare meqenëse duhet kohë që ndryshimet në politikën monetare të japin ndikimin

e vet në çmime. Në periudha afatshkurtra, çmimet përcaktohen nga faktorë të tjerë, si ndryshime në çmimet e lëndëve të para ose ndryshime në nivelin e taksave për mallra. Kështu, qëllimi është ruajtja e stabilitetit të çmimeve në periudha afatmesme dhe afatgjata. Luhatjet sezonale dhe efekte të tjera për periudha shumë të shkurtra nuk duhet të konsiderohen si shmangie nga objektivi i stabilitetit të çmimeve.

PAVARËSIA E BANKËS QENDRORE EVROPIANE

Pavarësia është një element jetësor për suksesin e çdo banke qendrore. Në përputhje me Traktatin për themelimin e Komunitetit Evropian, Eurosistemi gëzon pavarësi të plotë në zbatimin e funksioneve të veta: as Banka Qendrore Evropiane, as bankat qendrore kombëtare të Eurosistemit, as edhe ndonjë anëtar i organeve vendimmarrëse të tyre nuk kërkon apo merr udhëzime nga të tjerë. Institucionet e Komunitetit Evropian dhe qeveritë e shteteve anëtare janë të detyruara ta respektojnë këtë parim dhe nuk duhet të përpiqen të ndikojnë anëtarët e organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore Evropiane apo të bankave qendrore kombëtare. Eurosistemi ka në dispozicion të gjitha instrumentet dhe kompetencat e nevojshme për të ndjekur një politikë monetare efikase. Ai nuk mund të ofrojë hua për subjektet e Komunitetit Evropian apo për institucionet qeveritare të vendeve anëtare. Ky kufizim e mbron atë nga ndikimet politike. Për më tepër, Banka Qendrore Evropiane ka

buxhetin e saj, të pavarur nga Komuniteti Evropian dhe kjo e veçon atë nga interesat financiarë të Komunitetit.

Kapitali i Bankës Qendrore Evropiane nuk vjen nga Komuniteti Evropian, por është i paguar nga bankat qendrore të vendeve të Bashkimit Evropian. Ajo çka përcakton kuotën e kapitalit për çdo bankë qendrore është përqindja që zë PBB-ja dhe popullsia e vendit të saj në Komunitet. Anëtarët e organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore Evropiane emërohen për periudha të gjata dhe mund të hiqen nga detyra vetëm për arsye të sjelljes jo të mirë dhe të paaftësisë në punë.

Në nivel ndërkombëtar, ekzistojnë marrëveshje për përfaqësimin e Bankës Qendrore Evropiane në organizma ndërkombëtarë si FMN-ja dhe OECD-ja (Organizata për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik). Banka Qendrore Evropiane merr pjesë në takimet e këtyre organizatave ndërkombëtare me qëllimin e vetëm të shkëmbimit të informacionit. Kështu, pavarësia e Bankës Qendrore Evropiane respektohet plotësisht.

TRANSPARENCA E BANKËS QENDRORE EVROPIANE

Për të ruajtur kredibilitetin e vet, një bankë qendrore e pavarur duhet të tregohet e hapur dhe e qartë në arsyet e vendimeve që merr. Gjithashtu, ajo duhet të jetë e përgjegjshme përpara institucioneve demokratike për këto vendime. Pa cënuar pavarësinë e Bankës Qendrore Evropiane, Traktati përcakton detyrime për raportimin e aktivitetit të saj.

Çdo javë, Banka Qendrore Evropiane publikon pasqyrat e konsoliduara financiare të Eurosistemit. Këto pasqyra reflektojnë transaksionet monetare dhe financiare që kanë ndodhur në Eurosistem gjatë javës së kaluar. Të paktën një herë në çdo tre muaj, Banka Qendrore Evropiane duhet të publikojë një raport mbi aktivitetet e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Gjithashtu, ajo duhet të dorëzojë një raport vjetor mbi këto aktivitete dhe mbi politikën monetare të vitit në vazhdim dhe të një viti më parë, përpara Parlamentit Evropian,

Këshillit të Bashkimit Evropian, Komisionit Evropian dhe Këshillit Evropian. Publikimet e Bankës Qendrore Evropiane janë të disponueshme sipas kërkesës ose mund të gjenden në faqen e internetit të Bankës Qendrore Evropiane.

Parlamenti Evropian mund të thërrasë një seancë diskutimi mbi Raportin Vjetor të Bankës Qendrore Evropiane. Presidenti i saj dhe anëtarë të tjerë të Bordit Ekzekutiv, me kërkesë të Parlamentit Evropian ose me iniciativën e tyre, mund të shfaqin mendimet e veta përpara komiteteve përkatëse të Parlamentit Evropian. Kjo gjë ndodh zakonisht çdo tre muaj.

Në fakt, Banka Qendrore Evropiane është angazhuar të tejkalojë detyrimet që i përcaktohen në Traktat përsa i përket raportimit të aktivitetit të saj. Përveç zbatimit të këtyre detyrimeve, Presidenti i Bankës Qendrore Evropiane angazhohet të shpjegojë arsyet për vendimet që merr Këshilli Drejtues në konferencën e shtypit, që mbahet menjëherë pas mbledhjes së parë të Këshillit, çdo muaj.

Pikëpamjet e Këshillit Drejtues për situatën ekonomike dhe për pritshmëritë për ecurinë e çmimeve, publikohen në buletinet mujore të Bankës Qendrore Evropiane, të cilat janë të disponueshme në 11 gjuhët e Komunitetit Evropian.

Gjithashtu, një nga anëtarët e Komisionit Evropian ka të drejtën e pjesëmarrjes në takimet e Këshillit Drejtues dhe të Këshillit të Përgjithshëm, por nuk gëzon të drejtën e votës. Si rregull, Komisioni Evropian përfaqësohet nga një komisioner përgjegjës për çështjet ekonomike dhe financiare.

Banka Qendrore Evropiane ka ndërtuar marrëdhënie reciproke me Këshillin e Bashkimit Evropian. Nga njëra anë, Presidenti i Këshillit të Bashkimit Evropian mund të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe të Këshillit të Përgjithshëm të Bankës Qendrore Evropiane. Ai mund të propozojë mocione për t'u diskutuar në

Këshillin e Përgjithshëm, po nuk ka të drejtë të votojë. Nga ana tjetër, Presidenti i Bankës Qendrore Evropiane ftohet në mbledhjet e Këshillit të Bashkimit Evropian, kur në të diskutohen çështje që lidhen me detyrat dhe me objektivat e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Përveç takimeve zyrtare dhe joformale të Këshillit ECOFIN (që përbëhet nga ministrat e ekonomisë dhe të financës së vendeve të Bashkimit Evropian), Presidenti merr pjesë edhe në takimet e Eurogrupit (që përbëhet nga ministrat e ekonomisë dhe të financës së Eurozonës).

Guvernatorët e bankave qendrore kombëtare janë të pranishëm në takimet joformale të ECOFIN-it. Gjithashtu, Banka Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore kombëtare të vendeve të Bashkimit Evropian përfaqësohen në Komitetin Ekonomik dhe Financiar, organ këshillues i Komunitetit Evropian që trajton një sërë problemesh ekonomike për Evropën.

STRATEGJIA DHE INSTRUMENTET E BANKËS QENDRORE EVROPIANE

Mënyra me të cilën Banka Qendrore Evropiane ndjek dhe synon të realizojë objektivin kryesor të saj, atë të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, përcaktohet në atë që quhet strategjia e politikës monetare. Këshilli Drejtues ka zgjedhur një strategji, e cila mundohet t'u afrohet politikave që kanë ndjekur bankat qendrore kombëtare përpara se të hynin në Bashkimin Monetar. Në të njëjtën kohë, hyrja e euros ka sjellë një situatë krejt të re, e cila është marrë parasysh kur është hartuar politika monetare e Eurozonës.

Strategjia mbështetet në dy shtylla kryesore:

Shtylla e parë

Paraja. Duke u nisur nga parimi se inflacioni është rezultat i ekzistencës së një sasie të madhe parash të disponueshme për blerjen e një sasie të kufizuar mallrash dhe shërbimesh, Banka Qendrore Evropiane ka vendosur një objektivi për nivelin e ofertës së parasë që qarkullon në

Eurozonë. Oferta monetare përcaktohet nga agregati monetar i njohur si M3, i cili mat sasinë e parasë në qarkullim, depozitat afatshkurtra pranë institucioneve të kreditit e institucioneve të tjera financiare dhe sasinë e letrave me vlerë afatshkurtra që lëshojnë këto institucione. Norma e referencës, e vendosur për rritjen vjetore të M3 (që nga viti 1999 kjo normë është 4½ për qind) synon të ndihmojë Këshillin Drejtues në analizimin dhe në raportimin e informacionit që mbartin agregatët monetarë, në mënyrë që ky të shërbejë si udhëzim koherent dhe i besueshëm për politikën monetare.

Shtylla e dytë

Vlerësimi i përgjithshëm, i ardhmërisë së ecurisë së çmimeve dhe i rreziqeve që kërcënojnë stabilitetin e çmimeve në Eurozonë. Ky vlerësim bëhet duke marrë për bazë një grup treguesish ekonomikë, të cilët mendohet se ofrojnë informacion mbi zhvillimet e çmimeve në të ardhmen. Si shembuj të këtyre treguesve mund të përmendim pagat, kursin e këmbimit, normat e interesit për

periudhat afatgjata, matje të ndryshme të aktivitetit ekonomik, tregues të politikës fiskale, indeksat e çmimit dhe të kostos, vrojtime të besimit të biznesit dhe të konsumatorëve.

Gjithësesi, të dyja shtyllat e strategjisë që ndjek Banka Qendrore Evropiane, sigurojnë monitorimin dhe analizimin nga afër të zhvillimeve monetare, financiare dhe ekonomike. Kjo analizë tërësore mundëson vendosjen e normave të interesit në nivele që i shërbejnë më së miri ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Duke mbrojtur fuqinë blerëse të euros në këtë mënyrë, politika monetare e Bankës Qendrore Evropiane përkrah edhe vlerën e euros jashtë Zonës, e cila matet nga kursi i këmbimit të euros kundrejt

monedhave të tjera. Megjithatë, kursi i këmbimit në vetvete nuk është objektiv i politikës së Bankës Qendrore Evropiane.

Me qëllim që të arrihet objektivi kryesor i ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, Eurosistemi ka në dispozicion të tij një grup instrumentesh. Ato shërbejnë për të ndikuar tek normat e interesit në treg e tek likuiditeti i sistemit bankar dhe për të sinjalizuar drejtimin e politikës monetare. Ndonëse politika monetare formulohet nga Këshilli Drejtues i Bankës Qendrore Evropiane, implementimi i saj është i decentralizuar dhe shumë nga operacionet kryhen nga bankat qendrore kombëtare.

INSTRUMENTET MË TË RËNDËSISHME

Operacionet rfinansuese përdoren për të siguruar likuiditet të mjaftueshëm në sistemin bankar dhe për të sinjalizuar pozicionin e politikës monetare. Ato kryhen një herë në javë dhe kanë maturitet dyjavor.


Operacione rfinansimi afatgjata janë transaksionet që sigurojnë likuiditet, por që kryhen në frekuenca mujore dhe kanë maturitet tremujor.

Operacionet rregulluese kryhen në raste të veçanta me qëllim rregullimin e normave të interesit dhe administrimin e likuiditetit në treg kur ka luhajtje të papritura të tij.

Vendosja e *rezervës së detyrueshme* mbi institucionet e kreditit, synon të stabilizojë kërkesën për paratë e bankës qendrore. Secili nga institucionet e kreditit duhet të mbajë një depozitë pranë Eurosistemit, e llogaritur si përqindje e depozitave të klientëve të institucionit. Kjo gjë stabilizon normat e interesave në tregun e parasë.

Kredia njëditore e ofruar nga Banka Qendrore Evropiane i lejon palës tjetër (institucioneve financiare si bankat) të marrin likuiditet njëditor nga Eurosistemi. E kundërta ndodh për *depozitat njëditore* që institucionet mbajnë pranë Bankës Qendrore Evropiane.

Tregu i Eurozonës nuk mund të funksiononte pa mbështetjen në sistemin e pagesave të njohur me emrin TARGET. Ky sistem lidh së bashku sistemet e pagesave të 15 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian me njëra-tjetrën dhe me Bankën Qendrore Evropiane. Kjo mundëson transferimin e sasive të konsiderueshme të parave ndërmjet llogarive bankare nga një cep i Bashkimit Evropian në cepin tjetër brenda pak minutave, në mos brenda pak sekondave. Sistemi TARGET lehtëson zhvillimin e një tregu të njësuar të parasë në Evropë dhe mundëson pagesat ndërmjet vendeve, prej rreth 400 miliardë euro në ditë. Po t'i shtojmë këtyre edhe pagesat brenda një vendi, kjo vlerë shkon në 1 trilion euro. TARGET ka treguar se është një sistem i sigurtë dhe i besueshëm. Sot ai konsiderohet si një nga sistemet e pagesave më të rëndësishme në Evropë dhe një nga tre më të mëdhatë në botë.



FJALORTH

Agregatët monetarë (M1, M2, M3): Përcaktohen si shuma e parasë në qarkullim, plus disa lloje detyrimesh të institucioneve financiare, që në një kuptim të gjerë konsiderohen të një shkalle të lartë likuiditeti.

Banka Qendrore Evropiane (ECB): është themeluar si një subjekt ligjor i pavarur më 1 qershor 1998 me seli në Frankfurt am Main, Gjermani. Ajo u krijua me qëllim që të garantonte se detyrat dhe funksionet e Eurosistemit dhe të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore zbatoheshin ose nëpërmjet vetë Bankës Qendrore Evropiane ose nëpërmjet bankave qendrore kombëtare.

Bankë qendrore: institucion, i cili, sipas një dokumenti ligjor është përgjegjës për hartimin dhe për zbatimin e politikës monetare të një vendi.

Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (EMU): Traktati që themelon Komunitetin Evropian dhe përshkruan procesin e arritjes së Bashkimit Ekonomik dhe Monetar në tre faza.

Faza e parë filloi në korrik 1990 dhe përfundoi më 31 dhjetor 1993. Ajo u karakterizua nga heqja e të gjitha barrierave për lëvizjen e lirë të kapitalit brenda Bashkimit Evropian. Faza e dytë filloi më 1 janar 1994. Midis të tjerash, gjatë kësaj faze u krijua Instituti Monetar Evropian (EMI), u ndalua financimi i sektorit publik nga banka qendrore dhe u vendosën kufizime për nivelin e deficitit buxhetor. Faza e tretë filloi më 1 janar 1999 me transferimin e kompetencave monetare tek Eurosistemi, fiksimin e kursit të këmbimit midis monedhave që përdornin vendet e Bashkimit Evropian dhe me prezantimin e euros.

Bordi Ekzekutiv: një nga organet vendimmarëse të Bankës Qendrore Evropiane. Ai përbëhet nga Presidenti, Zëvendëspresidenti i Bankës Qendrore Evropiane dhe katër anëtarë të tjerë.

Kriteret e konvertimit: një grup kriteresh me natyrë ekonomike, të cilat duhen përmbushur nga anëtarë të Bashkimit Evropian përpara se këto të bëhen pjesëmarrëse të Eurozonës. Këto kritere njihen ndryshe me emrin kriteret e Maastricht-it dhe midis të

tjerash përfshijnë arritjen e një norme të ulët inflacioni, kurse këmbimi të qëndrueshme, norma interesash të ulëta dhe të qëndrueshme etj.. Këto janë përshkruar në Traktatin për themelimin e Komunitetit Evropian dhe në protokollet bashkëngjitur këtij Traktati.

Institucion krediti: “ndërmarrje qëllimi ekonomik i së cilës është ai i mbledhjes së depozitave ose fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe dhënia e kredive për llogari të vet.” (Artikulli 1 i Direktivës së Parë të Koordinimit Bankar (First Banking Coordination 77/780/EEC)). Bankat tregtare dhe ato të kursimit janë llojet e institucioneve të kreditit që ndeshen më shpesh.

ECOFIN: shih Këshillin e Bashkimit Evropian.

Euro: emri i monedhës së vetme evropiane. Ky emër u pranua nga Këshilli Evropian në takimin e tij në Madrid më 15-16 dhjetor 1995, për të zëvendësuar termin ECU.

Eurosistemi: përfshin Bankën Qendrore Evropiane dhe bankat

qendrore kombëtare të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat kanë adoptuar monedhën euro në fazën e tretë të krijimit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

Faza e tretë: shih Bashkimin Ekonomik dhe Monetar (**EMU**).

Grupi i Euros: takim joformal i ministrave të ekonomisë dhe financës të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian që bëjnë pjesë në Eurozonë. Në takimet e Grupit të Euros, ministrat flasin për çështje që lidhen me përgjegjësitë e tyre për ecurinë e euros. Komisioni Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane janë të ftuar të marrin pjesë në këto takime. Grupi i Euros zakonisht takohet menjëherë përpara një takimi të planifikuar të ECOFIN-it.

Inflacioni: rënie progresive e vlerës së parasë, gjë që tregohet nga rritja e vazhdueshme e nivelit të përgjithshëm të çmimeve (shih edhe **Deflacion** dhe **Stabilitet Çmimesh**).

Instituti Monetar Evropian (EMI): Instituti Monetar Evropian ishte një institucion i përkohshëm, i themeluar

në fillim të fazës së dytë të Bashkimit Monetar Evropian (më 1 janar 1994). EMI nuk ishte përgjegjës për drejtimin e politikës monetare në Bashkimin Evropian. Detyrat kryesore të EMI-t lidheshin me forcimin e bashkëpunimit midis bankave qendrore dhe koordinimin e politikës monetare si edhe me përgatitjen e fazës së tretë të Bashkimit Monetar Evropian. EMI pushoi së ekzistuari në 1 qershor 1998.

Këshilli i Bashkimit Evropian: organ i përbërë nga përfaqësues të qeverive të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, zakonisht nga ministrat përgjegjës për çështjet nën shqyrtim (për këtë arsye shpeshherë njihet si Këshilli i Ministrave). Këshilli i Bashkimit Evropian që mbledh ministrat e ekonomisë dhe të financës, shpeshherë thirret me emrin Këshilli i ECOFIN-it.

Këshilli drejtues: një nga organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore Evropiane. Ai përbëhet nga të gjithë anëtarët e Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore Evropiane dhe guvernatorët e bankave qendrore të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat kanë adoptuar monedhën euro.

Këshilli Evropian: përbëhet nga kryetarët e shteteve ose të qeverive të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe nga Presidenti i Komisionit Evropian (shih edhe **Këshillin e Bashkimit Evropian**).

Këshilli i përgjithshëm: një nga organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore Evropiane. Ai përbëhet nga Presidenti dhe Zëvendëspresidenti i Bankës Qendrore Evropiane dhe nga guvernatorët e bankave qendrore të 15 vendeve anëtare në Bashkimin Evropian.

Komisioni Evropian: Institucion i Komunitetit Evropian, i cili siguron zbatimin e klauzolave të Traktatit, zhvillon politikën e Komunitetit, propozon legjislacionin për Komunitetin dhe ushtron pushtet në fusha të caktuara. Në fushën e politikës ekonomike Komisioni rekomandon udhëzime mbi politikën ekonomike të Komunitetit dhe raporton përpara Këshillit të Bashkimit Evropian mbi zhvillimet dhe politikën ekonomike. Ai monitoron financat publike në kuadrin e mbikëqyrjes shumëpalëshe dhe dorëzon raporte te Këshilli i Bashkimit

Evropian. Komisioni përbëhet nga 20 anëtarë duke përfshirë nga dy persona me kombësi nga Gjermania, Spanja, Franca, Italia dhe Britania e Madhe dhe nga një person nga secili vend tjetër anëtar i Bashkimit Evropian.

Komiteti Ekonomik dhe Financiar (EFC): organ konsultativ pjesë e Komunitetit Evropian, që është krijuar në fillim të Fazës së Tretë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Anëtarë të Bashkimit Evropian, të Komisionit Evropian dhe të Bankës Qendrore Evropiane kanë të drejtë të emërojnë jo më shumë se dy persona si anëtarë të Komitetit Ekonomik dhe Financiar.

Kriteret e Maastricht-it: shih kriteret e konvertimit.

Likuiditet: lehtësia dhe shpejtësia me të cilën asetet financiare mund të konvertohen në para *cash* ose të përdoren për të shlyer detyrimet. Në këtë kuptim, paraja *cash* është aseti më likuid. Depozitat janë asete më pak likuide, në varësi të maturitetit të tyre. Termi “likuiditet” përdoret shpesh si sinonim për “paranë”.

M3: agregati monetar M3 është përcaktuar nga Banka Qendrore Evropiane si paraja në qarkullim plus zotërimet e rezidentëve të Eurozonës (përveç bankave qendrore) si: depozita njëditore, depozita me afat deri në dy vjet, depozita likuide deri në tre muaj, repo, zotërimet në tregun e parasë, letra me vlerë me maturitet deri në dy vjet.

Operacione në tregun valutor: blerja dhe shitja e valutës. Në kontekstin e Eurosistemit, kjo nënkupton blerjen dhe shitjen e euros kundrejt monedhave të tjera të përdorshme jashtë Eurozonës.

Operacione rregulluese: operacione në treg të hapur jo të zakonshme, që realizohen nga Eurosistemi kryesisht për të zgjidhur situata të paparashikuara të luhatjes së likuiditetit në treg.

Organizata për zhvillimin dhe bashkëpunimin ekonomik (OECD): OECD (me seli në Paris) u themelua më 1961 si pasardhëse e Organizatës për Bashkëpunimin Ekonomik Evropian (OEEC). Ajo përbëhet nga 29 vende (sipas statistikave të vitit 2001) dhe

funkcioni kryesor i saj është t'u sigurojë shteteve një ambient për diskutimin, zhvillimin dhe perfeksionimin e politikave ekonomike e sociale.

Paraja: aset që me konsensus të gjerë është pranuar si mjet shkëmbimi. Për shembull, ajo mund të jetë në formën e monedhave apo të kartëmonedhave ose të njërive të depozituara në një kartë elektronike. Depozitat afatshkurtra pranë institucioneve të kreditit i shërbejnë funksionit të parasë. Sipas përkufizimit teorik në ekonomi, paraja ka tre funksione. Ajo shërben si (1) njësi llogaritjeje (2) mjet pagese, dhe (3) ruajtëse e vlerës. Banka qendrore është përgjegjëse për kryerjen optimale të këtyre funksioneve nëpërmjet ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

Parlamenti Evropian: përbëhet nga 626 përfaqësues të qytetarëve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Ai është pjesë e procesit ligjvënës, ndonëse me të drejta të veçanta në varësi të procedurave nëpërmjet të cilave hyjnë në fuqi ligjet e Bashkimit Evropian. Në kuadrin e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, Parlamenti ka kryesisht fuqi konsultative. Megjithatë,

Traktati përcakton disa procedura për përgjegjshmërinë e Bankës Qendrore Evropiane përpara Parlamentit (prezantimi i Raportit Vjetor, debati mbi politikën monetare, dëgjimet përpara komiteteve parlamentare kompetente).

Politika monetare: veprime që ndërmerr banka qendrore me qëllim që të arrijë objektivat e veta (për shembull, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve) duke vënë në përdorim instrumentet që ka në dispozicion.

Rezerva e detyrueshme: detyrim i institucioneve të kreditit për të mbajtur një nivel të caktuar depozitash me bankën qendrore. Rezerva e detyrueshme e një institucioni krediti përlllogaritet si përqindje e depozitave nga klientët jobanka pranë tij.

Sistemi Evropian i Bankave Qendrore (ESCB): përbëhet nga Banka Qendrore Evropiane dhe nga bankat qendrore kombëtare të 15 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Stabiliteti i çmimeve: stabiliteti i çmimeve është përcaktuar nga Këshilli

Drejtuës i Bankës Qendrore Evropiane si rritja vjetore prej më pak se 2 për qind e nivelit të çmimeve të konsumit. As inflacioni i vazhdueshëm e as deflacioni nuk përputhen me këtë përcaktim të stabilitetit të çmimeve.

Traktati për themelimin e

Komunitetit Evropian: Traktati u nënshkrua në Romë më 25 mars 1957 dhe hyri në fuqi më 1 janar 1958. Traktati shënon themelimin e Komunitetit Ekonomik Evropian (EEC) dhe shpeshherë njihet si Traktati i Romës. Traktati për Bashkimin Evropian u nënshkrua në Maastricht (dhe shpeshherë njihet si Traktati i Maastricht-it) më 7 shkurt 1992 dhe hyri në fuqi më 1 nëntor 1993. Ai qe një

amendament i Traktatit të Romës, i cili sot njihet zyrtarisht si Traktati për themelimin e Komunitetit Evropian. Traktati për Bashkimin Evropian është rishikuar nga Traktati i Amsterdimit, i cili u nënshkrua më 2 tetor 1997 dhe hyri në fuqi më 1 maj 1999.

Tregu i parasë: në kontekstin e bankës qendrore, mund të përcaktohet si tregu për depozitat e bankës qendrore. Është një treg që përbëhet prej institucioneve financiare dhe ndërmjetëse, marrëveshjeve, lehtësimit të kredidhënies dhe huamarrjes në periudha afatshkurtra: nga njëditore në një vit. Kështu, tregu i parasë ndryshon nga ai i kapitalit në të cilin tregtohen kredi afatgjata dhe afatmesme.

INFORMACION:**Banka Qendrore Evropiane****European Central Bank**

Kaiserstrasse 29

60311 Frankfurt am Main

Tel.: +49 69 1344-0

www.ecb.int

Bankat qendrore të vendeve anëtare të
Bashkimit Evropian.

Austri**Oesterreichische Nationalbank**

Otto-Wagner-Platz 3

1090 Wien

Tel.: +43 1 40420-0

www.oenb.co.at**Belgikë****Nationale Bank van België/Banque****Nationale de Belgique**

de Berlaimontlaan 14

boulevard de Berlaimont 14

1000 Brussel

1000 Bruxelles

Tel.: +32 2 221 21 11

www.bnb.be**Britani e Madhe****Bank of England**

Threadneedle Street

London EC2R 8AH

Tel.: +44 20 7601 4444

www.bankofengland.co.uk**Danimarkë****Danmarks Nationalbank**

Havnegade 5

1093 København K

Tel.: +45 33 63 63 63

www.nationalbanken.dk**Finlandë****Suomen Pankki**

Snellmaninaukio

00101 Helsinki

Tel.: +358 9 1831

www.bof.fi**Francë****Banque de France**

39, rue Croix-des-Petits-Champs

75049 Paris Cedex 01

Tel.: +33 1 42 92 42 92

www.banque-france.fr

Gjermani**Deutsche Bundesbank**

Wilhelm-Epstein-Strasse 14

60431 Frankfurt am Main

Tel.: +49 69 95 66-1

www.bundesbank.de**Greqi****Bank of Greece**

21 E.Venizelos Avenue

10250 Athens

Tel.: +30 1 320 1111

www.bankofgreece.gr**Irlandë****Central Bank of Ireland**

Dame Street

Dublin 2

Tel.: +353 1 671 6666

www.centralbank.ie**Itali****Banca d'Italia**

Via Nazionale 91

00184 Roma

Tel.: +39 06 47921

www.bancaditalia.it**Holandë****De Nederlandsche Bank**

Westeinde 1

1017 ZN Amsterdam

Tel.: +31 20 524 91 11

www.dnb.nl**Luksemburg****Banque centrale du Luxembourg**

2, boulevard Royal

2983 Luxembourg

Tel.: +352 4774-1

www.bcl.lu**Portugali****Banco de Portugal**

148, Rua do Comércio

1101 Lisboa

Tel.: +351 21 313 00 00

www.bportugal.pt**Spanjë****Banco de España**

Calle Alcalá 50

28014 Madrid

Tel.: +34 91 3385000

www.bde.es

Suedi

Sveriges Riksbank

Brunkebergstorg 11

103 37 Stockholm

Tel.: +46 87 87 00 00

www.riksbank.se

Përgatitur sipas publikimit të Bankës

Qendrore Evropiane

“The European Central Bank”

© European Central Bank (ECB)

Frankfurt am Main, 2001.

Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi “Skënderbej”, Nr.1, Tiranë.

Tel : 355-4-222230; 235568; 235569.

Faks : 355-4-223558.

e-mail: public@bankofalbania.org

[http:// www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.

Tirazhi : 1000 kopje.